

Kujtim Kasami, PhD

**SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË - AKT ME RËNDËSI
HISTORIKE**

**ПРОГЛАСУВАЊЕ НА НЕЗАВИСНОСТ НА АЛБАНИЈА - ЧИН ОД
ИСТОРИСКО ЗНАЧЕЊЕ**

**THE DECLARATION OF INDEPENDENCE OF ALBANIA - AN ACT
OF HISTORICAL IMPORTANCE**

Abstract

This paper analyzes the proclamation of Albania's independence on 28 November 1912 as a decisive historical act resulting from centuries of Albanian political, military, cultural, and diplomatic struggle for statehood. It places independence within the context of the Albanian National Awakening, emphasizing key developments such as the League of Prizren, the spread of Albanian-language education, and major political and cultural initiatives that prepared the path to sovereignty. The study examines the role of the Vlo­ra Assembly, the establishment of the Provisional Government, and the international dimension of independence, particularly the decisions of the London Conference of Ambassadors, which led to the territorial division of Albanian lands. It also highlights the lasting national and symbolic importance of 28 November for Albanians across different regions and in the diaspora, presenting independence as both a historic achievement and an incomplete process shaped by geopolitical constraints.

Keywords: *Albanian Independence, Albanian National Awakening, Vlo­ra Assembly, Territorial Fragmentation*

Sot mbushen 112 vjet nga dita kur u shpall Pavarësia e Shqipërisë. Më 28 Nëntor 1912, Kuvendi Kombëtar i Vlorës shpalli Pavarësinë e Shqipërisë.

Akti i Shpalljes së Pavarësisë përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Ai ishte fryt i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të shqiptarëve, për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut dhe për të formuar shtetin e pavarur shqiptar.

Me vendimin e Kuvendit të Vlorës, kombi shqiptar fitoi të drejtën e tij të pamohueshme për të qenë i lirë e i pavarur, krahas kombeve e popujve të tjerë të Evropës.

Shpallja e Pavarësisë ishte një fitore e madhe e shqiptarëve edhe kundër politikës antishqiptare të monarkive fqinje ballkanike, kundër synimeve e planeve të tyre për copëtimin e plotë të Shqipërisë. Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë ishte fitore e përbashkët për të gjithë popullin shqiptar dhe për të gjitha forcat që kishin marrë pjesë në luftën për çlirimin kombëtar, me pushkë dhe me penë.

Për nder të festës së 28 Nëntorit, sot Fondacioni AXIS së bashku me QMBI dhe në bashkëorganizim me UNT në Shkup ka planifikuar të organizoj këtë konferencë shkencore, me studiuës nga mbarë hapësirat shqiptare si Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, në pikë të parë për të shënuar këtë ditë me rëndësi historike si dhe për të hedhur ca xixa të dritës për të ndriçuar këtë rrugëtim shekullor sa i ëmbël, po aq i hidhur si në kohën e Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, po ashtu edhe sot në rrethanat dhe situatat aktuale 112 vite pas.

28 Nëntori nuk bën pjesë në kalendarin e festave zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, as të Republikës së Kosovës, ani pse kjo ditë festohet çdo herë dhe e njëjta shpallet ditë pushimi në forma të ndryshme për të gjitha institucionet shtetërore. Historianët, edhe deputetë të kuvendeve të republikave respektive duhet të kërkojnë që kjo festë të jetë pjesë e kalendarit të festave zyrtare. Në këtë formë nuk do të cenohen vlerat kombëtare, përkundrazi në rrugën institucionale do të respektohet një akt me rëndësi të madhe historike, por jo vetëm.

Dita e Flamurit, 28 Nëntori, shënohet pothuajse kudo që flitet shqip, për fatin tonë të mirë, edhe nga mërgata shqiptare me shumë emocione dhe ndjenja atdhedashurie në forma të ndryshme dhe në bazë të mundësive të tyre shënohet dhe respektohet veçanërisht dita e 28 nëntorit, apo siç është e njohur në mesin e popullatës dhe mërgatës shqiptare Dita e Flamurit Kombëtar.

Kjo datë në të cilën, në vitin 1912 është shpallur Pavarësia e Shtetit Shqiptar në katër Vilajetet Shqiptare, përbën edhe histori të tjera për shqiptarët.

Me 28 Nëntor është ditëlindja e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jashari dhe data kur UÇK doli për herë të parë publikisht, në vitin 1997 në varrimin e mësuesit Halit Geci në Llaushë të Drenicës.

Krejt këto bëjnë që emocionet e shqiptarëve në këto ditë nëntori të jenë të mëdha, dhe pothuajse çdo gjë merr ngjyrën e festës.

Përkundër synimit për bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare dhe shpalljen e pavarësinë në këto territore, një gjë e tillë nuk u arrit, pasi ato u copëtuan në konferencën e ambasadorëve në Londër, nga Rusia dhe Franca me disa shtete të Ballkanit. Lidhja Shqiptare e Prizrenit më 1878, hapja e shkollës së parë shqipe në Korçë më 1887, Lidhja e Pejës më 1899, dhe Kongresi i Manastirit më 1908, i kanë paraprirë shpalljes së pavarësisë në vitin 1912, në Vlorë. Krahas tyre edhe iniciativat e atëhershme diplomatike të rilindësve tanë që angazhoheshin për çlirim nga osmanët, por edhe lufta ndaj popujve fqinje sllave të cilët kishin dhe vazhdojnë të kenë ‘apetite’ për trojet shqiptare.

Përpjekja e parë dhe serioze për formimin e shtetit shqiptar ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e cila bashkoi territoret shqiptare dhe se qysh në atë kohë dihehin në çfarë territore shtriheshin shqiptarët. Synimi fillimisht ka qenë autonomia brenda Perandorisë Osmane, e më pas pavarësia.

“Përpjekja e parë për formimin e shtetit shqiptar fillon që nga periudha e Lidhjes së Prizreni. Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte përpjekja më serioze për vënien e një fundamenti të rëndësishëm për krijimin e një shteti kombëtar shqiptar. Pavarësisht se ajo zgjati vetëm tri vite. Nga viti 1878 deri në 1881, por megjithatë edhe shqiptarët u afruan drejt Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe u dërgua një sinjal i qartë diplomacisë së fuqive të mëdha, por edhe Perandorisë Osmane se shqiptarët do të ndjekin shembullin e popujve tjerë të Ballkanit dhe do të krijojnë shtetin e tyre”.

Qëllimi kryesor ka qenë bashkimi i katër vilajeteve shqiptare në një të vetëm.

“Nga organizimi politik dhe ushtarak, Lëvizja Kombëtare Shqiptare kaloi në një formë tjetër, trajtë tjetër, të organizimit gjithëshqiptar. Këtu dua të vë në spikamë hapjen e shkollës shqipe. Hapja e shkollës shqipe ishte një sinjal i qartë që mobilizoi rreth vetës elitën intelektuale

të shqiptarëve. Pas hapjes së shkollës së parë, u organizuan edhe aktivitete të tjera. Ishte Lidhja Shqiptare e Pejës që ishte vazhdimësi e Lidhjes së Prizrenit. Pas shuarjes së Lidhjes së Pejës, kemi aktivitete kulturore nga viti 1908, ku u mblodhën elita intelektuale shqiptare dhe vendosen në Kongresin e Manastirit për alfabetin e gjuhës shqipe. Një vit më vonë, në vitin 1909, u vendos që të hapet shkolla normale e Elbasanit nga të cila do të dilnin mësues që do të përhapnin gjuhën shqipe, që do të shkruanin dhe do të përgatisnin gjenerata të tëra për perspektivën kombëtare. Që të gjithë së bashku kishin një objektivë madhore: lirinë e pavarësinë e shtetit shqiptar. Duhet pasur parasysh gjithmonë se përpjekjet e shqiptarëve kanë qenë për bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një vilajet të vetëm. Që nënkupton përfshirjen e gjithë gjeografisë shqiptare në një shtet të vetëm, pastaj të pavarur”.

E mbi shtrirjen e territorit shqiptar në atë kohë dhe numrin e popullsisë, jep të dhëna akademiku Beqir Meta. Ai thotë se territori i katër vilajeteve shqiptare, ai i Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës, qysh prej Lidhjes së Prizrenit ka qenë rreth 56000-58000 kilometra katror. Me një popullsi prej 2.2 milionë banorë deri në 2.5 sosh.

“Ishin katër vilajetet e njohura shqiptare, ishte vilajeti i Kosovës me qendër në Shkup, vilajeti i Shkodrës, vilajeti i Manastirit dhe i Janinës. Në këtë përmbledheshin gjithë territoret shqiptare. Sigurisht ka qenë një territor i madh shqiptar, është aty diku te 56-58 mijë kilometra katrorë. Pra, shumë më i madh se Shqipëria e sotme dhe Shqipëria bashkë me Kosovën sot. Kishte një popullsi mendohet nga 2.2 deri në 2.5 milionë banorë që ishin shqiptarë në atë kohë. Kishte qytete të mëdha, qendra tregtare që kishin një lidhje organike mes atyre qendrave dhe territoreve urbane dhe fshatare për rreth. Një lloj ekonomie funksionale. Objektivat kanë qenë krijimin e një shteti kombëtarë në këtë territor. Madje mendimtar si Samiu dhe tjerë kanë parashikuar liri të gjëra për minoritete që banonin brenda atij territori mund të quhet shumë të avancuara për kohën”, thotë ai.

Objektivi për bashkim të këtyre vilajeteve sipas profesor Metës, ka vazhduar edhe në shpalljen e pavarësisë në 1912. Teksa thotë se Pavarësia e Shqipërisë është shpallur për të gjitha territoret shqiptare. Historiani Meta thotë se në shpalljen e pavarësisë këto territore i kanë njohur si të banuara me shqiptarë edhe fuqitë e mëdha evropiane, por formalisht nuk i kanë pranuar. Këtë e siguron siç thotë, korrespondenca diplomatike Austro-Hungareze, Italiane, Britanike dhe në disa dokumente burimet Franceze.

“Lufta Ballkanike e bëri të domosdoshme shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, kështu kjo ishte iniciativa e mençur dhe e zgjuar e Ismail Qemali dhe patriotëve tjerë shqiptarë të cilët tashmë kërkuan shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Pavarësia e Shqipërisë është shpallur për të gjitha territoret shqiptare dhe për të gjithë popullsinë shqiptare... Qeveria e Vlorës ka bërë gjitha përpjekjet edhe në konferencën e ambasadorëve për të bërë të qartë edhe kërkuar territoret kombëtare në mënyrë krejtësisht të arsyeshme. Pra, atje ku shqiptarët ishin shumicë dërrmuese në këto territore. Këto territore janë njohur si territore shqiptare. Pa diskutim, po të shikojmë gjithë korrespondencën diplomatike të fuqive diplomatike, qoftë atë austro-hungareze, italiane, britanike në disa dokumente, burime franceze, por edhe ato ruse nuk e mohojnë që këto territore banohen me shumicë shqiptare”, thekson Beqir Meta.

Mbi përpjekjet për pavarësi dhe fillimin e luftërave ballkanike jep detaje studiuësja Prof. Ledia Dushku. Ajo thotë se kur fuqitë e mëdha u deklaruan për ndryshim të statusit në Ballkan, filluan tentativat për mbajtjen e një kuvendi për t’i mbledhur shqiptarët nga gjithë krahinat. Dushku thekson, se tentativa e parë ishte rreth muajit shtator të vitit 1912 nga Sylja Vlorën dhe të birin Eqrem Vlorën që kryesisht orientoheshin në aspektin diplomatik, por që dështoi. Pas saj ishte iniciativa e dytë nga Shkupi të Shoqërisë “Dora e Zezë” dhe “Shpëtimi”, nga Sali Gjuka, Mit’hat Frashëri, por pa sukses. Këto dështime, sipas saj, arritën për shkak të një mungesë të qendrës organizative nga shqiptarët, teksa u shpreh se në momentin e fundit të luftës ballkanike, atëherë kur u kuptua se Perandoria Osmane do të ishte humbësja e kësaj lufte erdhi iniciativa e tretë me sukses nga Ismail Qemali. I cili pasi siguroi mbështetjen austro-hungareze dhe italiane, shkoi në Kuvendin e Vlorës për të shpallë pavarësinë. Në këtë kuvend historik, Kosova sipas saj, përfaqësohej nga Rexhep Mitrovica, Sali Gjuka, Mit’hat Frashëri dhe Isa Boletini. Kjo dëshmohej edhe në fotografitë në Muzeun Kombëtar në Tiranë.

“Në një situatë të tillë, atëherë kur u kuptua se çadra osmane nuk mund t’i mbronte dot më, elita politike shqiptare, veçanërisht kur fuqitë e mëdha e deklaruan në fund të tetorit se status kuos në Ballkan, nuk mund të jetonte më, u shprehën në pajtim për prishjen e status kuos në Ballkan. Elita politike shqiptare kuptoi se duhet të reagonte. Më shumë se një aksion çlirimtar, tashmë veprimet e tyre duhet të ishin diplomatike. Pra vëmendja e tyre do të duhej të përqendrohej në kontakte të herëpashershme të menjëhershme me fuqitë e mëdha që mund të mbështesnin krijimin e një shteti autonom apo të pavarur shqiptar. Në

këtë kuadër na vijnë tre iniciativa të ndryshme nga elita politike shqiptare për mbajtjen e një kuvendi. Me anën e të cilin do të diskutohej se cili do të ishte qëndrimi i shqiptarëve në kuadër të luftë së parë Ballkanike. Iniciativa e parë në kohë vjen nga një pinjoll i familjes Vlora. Bëhet fjalë për Sylja Vlorën dhe të birin Eqrem Vlorën. Në përpjekje për të organizuar shqiptarët, ata lëshojnë telegrame për t'u mbledhur në Vlorë, në një kuvend të shqiptarëve për të diskutuar reagimin e shqiptarëve në kuadrin e luftës. Sigurisht në këtë moment nuk bëhet fjalë për krijimin e një shteti të pavarur shqiptar. Kërkesat maksimaliste të tyre shkonin deri tek autonomia. Mendohej një gjë e ngjashme sikur Lidhja e Prizrenit, vjen iniciativa e Ismail Qemali dhe e Luigj Gurakuqit, të cilit në fund të tetorit lënë Stambollin dhe shkojnë në Bukuresht. Kemi mbledhjen e Bukureshtit në 5 nëntor, sigurisht një mbledhje tejet e rëndësishme për organizimin e shqiptarëve. Por nuk e përcaktoi se Shqipëria do të ishte autonome apo e pavarur. Kjo do të përcaktohej duke marrë pajtimin e fuqive të mëdha. Dy mbështetësit kryesor ishin Austro-Hungaria dhe Italia. Pasi Ismail Qemali siguroi mbështetjen e tyre shkoi në Kuvendin e Vlorës”, thotë ajo.

Pas shpalljes së pavarësisë erdhën vendimet shumë të vështira për shqiptarët. Në situatën e krijuar në vitin 1913, u organizua konferenca e ambasadorëve në Londër, ku u copëtuan territoret shqiptare. Në lidhje me këtë, drejtori i Institutit të Historisë në Tiranë, Beqir Meta i paraqet propozimet e dhëna në atë kohë, nga palët përshirë Perandorinë Austro-Hungareze dhe ato Ruse. Sipas tij, austro-hungarezët me mbështetjen e Italisë dhe Gjermanisë, paraqitën një projekt kompromisi ku kufijtë e shtetit shqiptar i përfshinin një pjesë të Kosovës, por liheshin disa territore të banuara me shqiptarë jashtë. Kurse, propozimi më i keq në këtë konferencë ishte ai i Rusisë me mbështetjen e shteteve sllave, ku Shqipëria reduktohej në një Shqipëri të mesme me popullsi myslimane.

“Në konferencën e Londrës palët, blloqet dolën me variantet e tyre. Perandoria Austro-Hungareze që mbështetej nga Italia dhe Gjermania paraqiti një projekt të saj për kufijtë e shtetit shqiptarë që përfshinte edhe një pjesë të konsiderueshme të territorit të Kosovës. Jo gjithë, sepse duke treguar që ishte e gatshme që të bënte lëshime për të shkuar drejt një kompromisi. Ky ishte projekti më i favorshëm, por ama jo më i drejti për shqiptarët. Për faktin se linte shumë territore që banoreshin nga shqiptarët jashtë. Ky ishte një projekt kompromisi mbi të cilin Austro-Hungaria do të bënte lëshime të reja dhe do të tërhiqemi nga territore të reja. Qeveria Ruse, Perandoria Ruse, paraqiti një projekt

tjetër shumë të reduktuar. Shumë më të reduktuar se shteti i sotëm. E reduktonte Shqipërinë në një Shqipëri të mesme me popullsi myslimane. Ky ishte një projekt i Serbisë dhe Greqisë, pak a shumë me diferenca të vogla. Sigurisht duhet harta për t'i parë. Zgjidhja ka qenë një zgjidhje kompromisi, e mesme që janë bërë skonto nga projekti austro-hungarez. Por ama është zmadhuar territori që ka paraqitur projekti rus në konferencën e ambasadorëve. Sigurisht projektet që diskutoheshin zyrtarisht ishin të fuqive të mëdha. Ndërsa vendet e Ballkanit kanë paraqitur projektet e tyre kishin të drejtë, por nuk kishin materiale zyrtare për të marrë në shqyrtim. Komisioni i kufijve në konferencën e Londrës ka shqyrtuar këto projekte dhe mbi këto janë bërë kompromise”, thekson Meta.

E kompromisi në kuadër të diskutimeve të fuqive të mëdha ishte reduktimi i projektit austro-hungarez, që është Shqipëria e sotme, por edhe zmadhimi i projektit të prezantuar nga rusët. Mbi këtë kompromis u njohë dhe u pranua pavarësia e shtetit shqiptar nga fuqitë e mëdha.

“Kompromiset kanë qenë mbi interesat gjeopolitike të fuqive të mëdha. Austro-Hungaria kërkonte një shtet shqiptar, sepse donte të shmangte dominimin sllav në Ballkan, daljen e rusëve përmes Serbisë dhe Malit të Zi në Detin Adriatik. Franca dhe Rusia donin të zmadhonin sa më shumë shtetet ballkanike në kurriz të Shqipërisë. Pra Greqinë, Serbinë dhe Malin e Zi. Franca e kishte pranuar daljen e Rusisë në Adriatik, megjithëse kishte diferenca me Britaninë e Madhe”.

E për këtë vendim të konferencës së ambasadorëve në Londër, historiani Frashër Demaj thotë se më shumë se gjysma e territoreve shqiptare kanë mbetur jashtë shtetit shqiptar.

“Aty kanë mbetur jashtë shtetit shqiptar pas konferencës së ambasadorëve në Londër kanë mbetur jashtë mbi 24 mijë kilometra katror të territoreve shqiptarë të banuara me shqiptarë kanë mbetur jashtë shtetit shqiptarë. Këtu kemi parasysh kompletë krahinën e Çamërisë. Pastaj territoret perëndimore të Maqedonisë Veriore, pastaj ka mbetur jashtë Kosova kompletë përfshirë Luginën e Preshevës, e cila natyrisht atëherë ishte vilajet i Kosovës. Dhe ka mbetur një pjesë e territoreve shqiptare në Malësinë e madhe që ishin pjesë e vilajetit të Shkodrës”.

Populli shqiptar asnjëherë nuk u pajtua me këtë ndarje duke vazhduar luftën për bashkim me Shqipërinë. Pas copëtimit të shtetit shqiptar më 1913, që ishte e përfshirë në katër vilajete apo njësi administrative, territoret shqiptare u copëtuan duke mbet Çamëria e pushtuar nga grekët dhe pjesët e tjera ndër pushtimin jugosllavë. Tokat shqiptare gjatë pushtimit jugosllav u copëtuan përsëri duke i dhënë një pjesë Malit

të Zi, një pjesë Serbisë dhe gjysmën e Maqedonisë së sotme, e cila u krijua pas Luftës së Dytë Botërore, është me tokë shqiptare. Pas Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët nën pushtimin e Jugosllavisë, asnjëherë nuk u ndalën duke arritur që një pjesë të quajtur tani Kosovë të krijuar artificialisht nga ish-Jugosllavia (Vilajeti apo Republika e Kosovës me herët e kishte qendrën në Shkup) të marrin autonomin, të rikthejnë me protesta dhe gjak përdorimin e flamurit kombëtar më 1968, të themelojnë universitetin më 1970, të marrin të drejtat e Republikës me kushtetutën e 1974-tës, të kërkojnë Republikë me 1981 dhe pas një lufte të përgjakshme dy vjeçare më 1998-1999, me pushtuesin serbë, ku u vranë mijëra ushtarë shqiptarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u masakruan mijëra civilë dhe u dhunuan mbi 20.000 gra shqiptare, të Shpallet Pavarësia e Shtetit të Kosovës, në vitin 2008, shteti i dytë shqiptar në Evropë, Republika e Kosovës.

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, në shkurt të vitit 2008, u vendos që festë zyrtare të jetë 17 Shkurti, kurse 28 Nëntori mbeti vetëm tek festat memoriale. Kjo doli nga pakoja e Ahtisaarit, përmes së cilës edhe u shpall pavarësia.

Derisa 28 Nëntori nuk bënë pjesë në kalendarin zyrtar të festave në Kosovë dhe në Maqedoni, këtu dhe atje ka data të tjera që shënohen me festë dhe ditë pushimi, por që konsiderohen si të panevojshme.

Aktualisht shteti i Kosovës ka 11 festa zyrtare: Vitin e Ri, Krishtlindjet Ortodokse, Ditën e Pavarësisë së Kosovës, Pashkët Katolike, Pashkët Ortodokse, Ditën e Kushtetutës, Ditën Ndërkombëtare të Punës, Ditën e Evropës, Bajramin e Madh, Bajramin e Vogël dhe Krishtlindjet Katolike.

Ndërsa, Lista e festave shtetërore dhe fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut është kjo:

Që në fillim të vitit qytetarët e Maqedonisë së Veriut e fillojnë me disa ditë jo pune. Është festa e krishtlindjes, buzmi.

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut kanë pushuar më 1 janar, për shkak të vitit të ri dhe kjo ditë është jo pune për të gjithë qytetarët e shtetit.

Për festa shtetërore, të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut, pushojnë më 20 prill, për shkak të festës së Pashkëve. Pastaj më 1 maj, dita e punëtorëve. Më 24 maj, është dita e Shën Qirilit dhe Metodit.

Më 2 gusht, është dita e Republikës. Ditë tjetër pushimi është 8 shtatori, Dita e Pavarësisë. Qytetarët e Maqedonisë së Veriut pushojnë edhe më 11 tetor, dita e kryengritjes popullore. Në muajin tetor ditë jo

pune është edhe data 23, pasi kjo është dita e luftës revolucionare maqedonase. Sipas kalendarit të festave, festë shtetërore është edhe 8 dhjetori, dita Shën Klimentit të Ohrit.

Por përveç festave shtetërore, qytetarët e Maqedonisë së Veriut pushojnë edhe në festat fetare. Për qytetarët e besimit ortodoks, 19 janari është festë e Ujit të bekuar, pastaj 17 prilli, është e Premtja e Madhe, para Pashkëve.

Më 5 qershor, besimtarët ortodoksë festojnë festën e pesëdhjetores. Më 28 gusht, ortodoksët e festojnë ditën e Virgjëresës së madhe.

Qytetarët e besimit katolik festojnë më 13 prill, dita e Pashkëve. Më 1 nëntor, festa e shenjtoreve, dhe 25 dhjetor, dita e parë e Krishlindjes.

Për besimtarët myslimanë festë shtetërore është Festa e Fitër Bajramit, ndërsa festë fetare dhe ditë jo pune është festa e Kurban Bajramit.

Për bashkësinë etnike shqiptare në Maqedoninë e Veriut, ditë jo pune është 22 nëntori, dita e Alfabetit Shqip.

Qytetarët turq në Maqedoninë e Veriut festojnë më 21 dhjetor, dita e mësimit në gjuhën turke.

Për bashkësinë etnike serbe, ditë jo pune është 27 janari, dita e Shën Savës,

Për qytetarët e përkatësisë etnike rome, ditë jo pune është 8 prilli, dita ndërkombëtare e Romëve.

Për vllahët, ditë jo pune është 23 maji, dita ndërkombëtare e vllahëve.

Për hebrejntë, ditë jo pune është 28 shtatori, dita e Jom Kipurit.

Për boshnjakët ditë jo pune është 28 shtatori, dita ndërkombëtare e Boshnjakëve.

Festat si Dita e Kushtetutës, apo 1 Maji, po konsiderohen të panevojshme në Kosovë, që të jenë festa zyrtare dhe të njëjtat të jenë ditë pushimi, sikurse disa festa dhe ditë pushimi që janë të panevojshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Megjithatë nuk është ditë feste, 28 Nëntori - si akt historik dhe përmbajtësor për shqiptarët kudo që janë.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë ishte kurorëzim i përpjekjeve shekullore dhe luftërave të pareshtura që bënë shqiptarët për çlirimin e vendit.

Për fat të keq, Qeveria e Vlorës pati një jetë të shkurt, pasi pak më shumë se një vit Qeveria e Vlorës u detyrua të tërhiqet dhe t'i lëshoj vend një Qeverie të drejtuar nga një Princ i huaj i emëruar nga Fuqitë e Kohës.

Edhe më keq Shqipëria u godit në aspektin territorial, ushtritë e fqinjëve dhe luftërat ballkanike copëtuan gjysmën e territoreve të Shqipërisë, duke u aneksuar nga fqinjët, ndërsa Konferenca e Londrës e mbajtur më 1913 u pranoi pushtimet e territoreve shqiptare, duke i rruddhur kufijtë e Shqipërisë në mënyrë dramatike.

Gjysma e popullsisë shqiptare mbeten nën sundimin serbo-malazez dhe grek.

Pas shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912 u formuan edhe organet shtetërore, Pleqësia dhe Qeveria e dal nga Kuvendi i Vlorës. U ngritën forcat e armatosura dhe ato të rendit dhe nisi puna për konsolidimin e arsimit, shëndetësisë, administratës, etj.

Qeveria e Vlorës vuri gurët e parë për krijimin e një sistemi gjyqësor sipas modeleve evropiane. Gjuha shqipe u shpall si gjuhë zyrtare dhe u vendos hapja e shkollave shqipe prej vjeshtës 1914. Akti më i rëndësishëm juridik që nxori Qeveria e përkohshme e Vlorës ishte “Kanuni i përkohshëm i administratës civile të Shqipërisë”, që u botua në nëntor 1913.

Kuvendi Kombëtar i Vlorës zgjodhi edhe Pleqësinë që duhej të kryente funksionet një organi këshillues e mbikëqyrës të qeverisë, me kryetar Vehbi Agolli.

Qeveria e Vlorës:

Ismail Qemali, kryetar i Qeverisë dhe ministër i Punëve të Jashtme.

Dom Nikoll Kacërrri, Zv. Kryeministër

Mufid Bej Libohova, Ministër për Punët e Brendshme

Abdi bej Toptani, Ministër për Financat

Mehmet Pashë Deralla, Ministër për Luftën (Mbrojtjen)

Petro Poga, Ministër për Drejtësinë

Luigj Gurakuqi, Ministër për Arsimin

Mit’hat bej Frashëri, Ministër për Punët Botore

Pandeli Cale, Ministër për Bujqësinë

Lef Nosi, Ministër i Post-Telegrafit.

Me aktin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Kryetari i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali njoftoi gjashtë Fuqitë e Mëdha: Anglinë, Italinë, Austro-Hungarinë, Francën, Gjermaninë dhe Rusinë.

Po ashtu, u njoftuan edhe shtetet ballkanike: Rumania, Mali i Zi, Serbia, Bullgaria, Greqia e Turqia, duke u kërkuar njohjen e pavarësisë,

si rrjedhojë e natyrshme e vullnetit të popullit shqiptar. Më 28 Nëntor, Ismail Qemali u shpall kryetar i Kuvendit dhe kryetar i parë i qeverisë së shtetit shqiptar. Pavarësia u shpall për të gjitha trojet shqiptare dhe ministrat u zgjodhën nga të gjitha krahinat shqiptare.

Akti i Shpalljes së Pavarësisë përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Ai ishte fryt i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të shqiptarëve, për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut dhe për të formuar shtetin e pavarur shqiptar. Me vendimin e Kuvendit të Vlorës, kombi shqiptar fitoi të drejtën e tij të pamohueshme për të qenë i lirë e i pavarur, krahas kombeve e popujve të tjerë të Evropës.

28 Nëntori i vitit 1912 shënon një kthesë historike për popullin shqiptar, sepse u krijuan kushtet e reja politike për zhvillimin më të shpejtë ekonomik, shoqëror e kulturor.

Shpallja e Pavarësisë ishte një fitore e madhe e shqiptarëve edhe kundër politikës antishqiptare të monarkive fqinje ballkanike, kundër synimeve e planeve të tyre për copëtimin e plotë të Shqipërisë.

Gëzuar Dita e 28 Nëntorit!

Gëzuar Festa e Flamurit Kombëtar Shqiptar!

Recensentë:

Dr. Ardian Muhaj

Dr. Ilmi Veliu

Bibliografia:

Hafiz Ibrahim Dalliu, Patriotizma në Tiranë, Botimi I-rë, 1930.

Kristo Frashëri, Historiku i Tiranës, Vëll. I, Tiranë: Toena, 2004.

Lef Nosi, Dokumenta Historike 1912-1918, Botimi II-të, Instituti i Historisë, Tiranë, 2007.

Hafiz Ali Korça, Shtatë ëndrrat e Shqipërisë, Tiranë: Shtypshkronja Mbrothësia, 1924 dhe ribotim i II-të, Shtypshkronja e Shtetit, 1944, dhe ribotim i III-të, Tiranë 2006.

Lufta e Popullit Shqiptar për Çlirim Kombëtar 1918-1920, Vëllimi II-të, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti Historisë, 1976.

Igli Gugashi, Gjeneza e fisit Ndroqi, Tiranë: Almera, 2008.

Tirana 1604-1937 Botue prej Bashkisë me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë. Shtypshkronja “Luarasi”, Tiranë 1937.

Justin Godart, Ditarët Shqiptarë mars 1921-dhjetor 1921, Tiranë: Dituria, 2008.

Prof. Sinan Tafaj “Figurë e shquar e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare – Ismail Ndroqi” 1876-1944, në librin Disa fetarë patriotë, muslimanë shqiptarë, Imam Vehbi Ismaili, Botim i I-rë, Albanian Islamic Centre, Michigan: Harper Woods, 1992.

Aurel Plasari. Referat si dhe bisedë në TVSH, “Përvjetori i ngritjes së Bibliotekës Kombëtare”, korrik 2012.

Imam Vehbi Ismaili, Disa fetarë patriotë muslimanë shqiptarë, Botim i I-rë, Michigan: Harper Woods, 1992.

Shefqet Ndroqi, Një jetë për jetën, Tiranë: Dritëro, 1998.